



## Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës Rahovec  
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 04/101 Nr. i faq/Br.str/No.pg 84

Date/Datum/Date 25.02 / 2026

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 17 shkronja (h) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, nenit 14 paragrafi 8 pika 8.1 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.11, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.8 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, propozimit të Drejtorisë për Arsim në Komunën e Rahovecit me Nr. Reference 04/1058 të dt. 02.02.2026, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me dt. 25.02.2026 miraton këtë:

### V E N D I M

**Për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit/es dhe zëvendësdrejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese të arsimit parauniversitar (IEAA-AP)**

- 1. Caktohet komisioni për përzgjedhjen e drejtorit/es dhe zëvendësdrejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese të arsimit parauniversitar (IEAA-AP) në Komunën e Rahovecit, të cilët konkurojnë në konkursin e shpallur nga Drejtoria për Arsim, në këtë përbërje:**
  - 1.1. Lulzim Krasniqi, Udhëheqës i Sektorit për Arsim, në Drejtorinë për Arsim, kryesues
  - 1.2. Shemsije Shala, Drejtoreshë në SHFMU “Dëshmorët e Zatriqit” në Zatriq, anëtare
  - 1.3. Anëtari i tretë është nga MASHTI-i sipas Rregullores (QRK) Nr. 19/2024, anëtar.
- 2. Detyra e komisionit është intervistimi i kandidatëve që kanë konkuruar në konkursin e cekura në pikën 1 të këtij vendimi dhe në bazë të pikëve të fituara, bën ranglistën e kandidatëve dhe i rekomandojnë Kryetarit të Komunës emërim të kandidatëve më të suksesshëm për drejtor/eshë apo zëvendësdrejtor/eshë e IEAA-AP sipas konkursit.**
- 3. Obligohet komisioni përzgjedhës që punët të kryej duke u bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi në Republikën e Kosovës.**
- 4. Mandati i komisionit përzgjedhës të cekur në pikën 1 të këtij vendimi është 1 (një) vit.**
- 5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.**

*Vendimi u dërgohet:*

- *Anëtarëve të komisionit,*
- *Drejtorisë për Arsim,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

**01Nr.101/26**  
**Datë: 25.02.2026**

